

Enti shkollorë, 2707, 22.09.2020

Ku të shkoj pas shkollës fillore të ulët?

Cila shkollë fillore e larte (klasa e pestë) është e përshtatshme për fëmijën tim? Çfarë duhet të merret parasysh?

Oferta shkollore në nivelin sekondar I dhe II në rajonin arsimor të Bielefeld'it

Rajoni arsimor i Bielefeld'it ka ofertë të gjërë arsimore.

Në 62 shkollat komunale dhe private të cilat janë të ndara në Hauptschulen (në mbyllje e sipër), Realschulen, Gjinnaze, shkolla të mesme, shkolla gjithëpërfshirëse, kolegje profesionale dhe të tjera, themelet për një arsimim të suksesshëm po krijohen.

Prezantimi i shkollave të nivelit sekondar I dhe II

Shumë prindër pyesin veten, e veçanërisht kur fëmijët e tyre kalojnë nga shkolla fillore e ulët në shkollën fillore të lartë: a është shkolla e duhur për fëmijën tim? Cila shkollë fillore e lartë, karakterizohet nga cili profil?

Shumë shkolla në nivelin sekondar I dhe II u ofrojnë prindërve dhe nxënësve të interesuar mbledhje informative, ditë të veçanta ku mundën ta vizitojnë shkollën ose oferta të tjera që japin një përshtypje për shkollën apo konceptin e shkollës dhe jetës shkollore dhe në formë konkrete ofrojnë informacione specifike për ndonjë shkollë të caktuar. Datat e mundshme janë (zakonisht nga nëntori deri në shkurt) dhe ofertat publikohen nga shkollat në faqet e tyre përkatëse të internetit.

Këshilla për zgjedhjen e një shkolle

Aspektet e mëposhtme duhet të merren parasysh kur përzgjedhni një shkollë:

- Niveli i arritshmërisë
- Sjellja
- interesat
- Zhvillimi i mësimi
- Sjellja shoqërore
- Aftësitë

Veçanërisht vendimtare është puna dhe sjellja shoqërore e fëmijës. Sa janë të theksuara aspektet e ndryshme të punës dhe sjelljes sociale tek fëmija juaj? Lidhur me këtë çështje flisni me mësimdhënësit e fëmijës tuaj.

Sjellja

- Gatishmëria e të mësuarit dhe arritshmërisë
- Qëndrueshmëria, koncentrimi sidhe ngarkesa
- Besueshmëria dhe kujdesi

- Aftësia e të menduarit, kreativiteti dhe fleksibiliteti
- Sjellja përgjat zgjidhjes së problemeve sidhe synimi i caktuar
- pavarësia dhe vetëbesimi

Sjellja shoqërore

- Aftësia për të bashkëpunuar dhe punuar në grup
- Menaxhimi i konfliktit dhe toleranca
- Aftësia për kritikë
- Gatishmëria për të ndihmuar
- Gatishmëria për të marrë përgjegjësi
- Përbajtja e rregullave

Këshilla të tjera për përzgjedhjen e shkollës:

- Rekomandimi i marrë nga shkolla e ulët fillore për llojin e shkollës
- A përshtatet koncepti (pedagogjik) i shkollës me nevojat e fëmijës?
- Sipas mendimit tuaj, cila shkollë e mbështet më së miri fëmijën tuaj?
- Çfarë përshtypjesh kishte fituar fëmija i juaj përgjat vizitës në shkollë?
- Tema "rruga për në shkollë": A është e lehtë dhe e sigurt rruga e shkuarjes së fëmijës tuaj në shkollë?
- A është shkolla, një shkollë gjithëditore apo gjysmëditore? (A ka përkujdesje shkollore në orët e pasditës?)
- A është shkolla, një shkollë komunale apo private?
- Formoni mendimin tuaj personal! Vendimet e marra në bazë të një "reputacioni" të caktuar të shkollës nuk janë të këshillueshme.

Dëftesat gjysmë-vjetore, formularët e regjistrimit dhe regjistrimi

Në muajin janar, nga shkollat fillore të ulëta ipen dëftesat gjysmëvjetore dhe formularët e regjistrimit për shkollat e larta fillore komunale. Prindërit pranojnë një formular regjistrimi nga shkolla fillore e ulët e fëmijës së tyre. Ky duhet i plotësuar të merret me vete në ditën e regjistrimit në një shkollë fillore të lartë komunale. (Nëse fëmija është regjistruar në një shkollë private, prindërit do të marrin informacione mbi procesin e regjistrimit nga shkolla private përkatëse.)

Fëmija mund të regjistrohet në një shkollë fillore të lartë brenda periudhës katër-javore të regjistrimit (13 shkurt-12 mars 2021). (Datat e regjistrimit për shkollat fillore të larta private zakonisht bazohen në shkollat komunale.) Regjistrimi në shkollat fillore të larta bëhet në zyrën/ Sekretariatit e shkollës përkatëse të shkollës SEK I / II.

Çfarë duhet të sillen në regjistrim?

- Formularin e regjistrimit të plotësuar (Formularin e regjistrimit e pranoni nga shkolla juaj fillore e ulët.)

- Dëftesa e gjysëmvetorit të fundit (klasa 4) e fëmijës suaj nga shkolla fillore, sidhe rekomandimin për llojin e shkollës së ardhshme.
- Çertifikata e lindjes së fëmijës tuaj i cili do të regjistrohet në shkollën fillore të lartë
- Nëse posedohet: dëshmia e aftësisë së fëmijës tuaj për të notuar (-> p.sh. prova e notit "kali i detit")

Letër pranimi apo refuzimi?

Vendimi nëse fëmija juaj është pranuar në shkollën fillore të lartë, do të merret sa më shpejt që të jetë e mundur pasi të ketë mbaruar periudha e regjistrimit (jo më herët se 15 Mars 2021).

Ju do të informoheni nga shkolla fillore e lartë ,me shkrim në lidhje me këtë.

Nëse fëmija i juaj nuk është pranuar në një shkollë që keni përzgjedhur (p.sh. sepse nuk ka vende të mjaftueshme në shkollë), ju do të pranoni një njoftim- refuzimi sidhe fletën origjinale të regjistrimit nga kjo shkollë. Me letër-refuzimin dhe fletë-regjistrimin, ju mund të regjistroni fëmijën tuaj në një shkollë tjetër të lartë fillore. Me ndihmën e një liste vazhdimisht të aktualizuar, që paraqitur në faqen e internetit të Qytetit Bielefeld, mund të shihni vetë se cilat shkolla fillore të larta në Bielefeld kanë akoma vende të lira.

Për shkak të situatës aktuale ('pandemia e virusit korona'), ju lutemi regjistroni fëmijën tuaj vetëm me shkrim (me postë ose duke e hedhur fleteregjistrimin në kutinë postare të ndërtesës së shkollës) në shkollën fillore të lartë të dëshiruar.

Shpenzimet e udhëtimit / karta e nxënësit/ bileta e rrugës për në shkollë Kur do të merrni një kartë nxënësi falas për fëmijën tuaj?

Karta e nxënësit së pari u vendos në vitin shkollor 2020/2021. Oferta e re për nxënësit e Bielefeldit në shkollat e komunës * është e vlefshme si një leje mujore për të gjithë transportin publik në nivelin e çmimit BI dhe është e vlefshme pa kufizime, gjatë gjithë kohës, gjatë gjithë vitit (për udhëtime nga dhe në shkollë dhe gjithashtu për udhëtime në kohën e lirë dhe në pushime). Karta e re e nxënësit duhet të porositet nëpërmes shkollës, pra duke mbushur formularin e plotë të porosisë (Bestellschein). Formulari i porosisë është gjithashtu online tek faqja Mobiel. Për më shumë informacione, shihni broshurën për shpenzimet e udhëtimit të nxënësit (Schülerfahrtkosten).

Karta e nxënësit e zëvendëson biletën e mëparshme të rrugës për në shkollë **. Nxënësit e nxënëset që kanë të drejtë aplikimi për shpenzimet e udhëtimit për nxënësit e shkollës pranojnë kartën e nxënësit me një çmim më të ulët (paguajnë vetëm një pjesë të saj, çdo muaj). Nxënësit e shkollës fillore të ulët, ata që janë në pronësi të një Bielefeld-Pass, sidhe ata që kanë të drejtë kërkesë për shpenzime udhëtimi për nxënësit e shkollës marrin Kartën e nxënësit falas. Atyre që nuk ju takon marrja e shpenzimeve të udhëtimit për në shkollë dhe nuk ju takon ndonjë shtesë, atëhere karta e re e nxënësit për ata që e paguajnë vetë kushton 29 euro në muaj. Informata shtesë mundeni të gjeni në fletën informuese Shpenzimet e udhëtimit të nxënësit (Schülerfahrtkosten)

Oferta e re e transportit publik për nxënësit e shkollave publike të qytetit të Bielefeldit u vendos nga Këshilli komunal i Bielefeld'it më 6 Shkurt 2020. Nuk egziston asnjë detyrim për të abonuar kartën e nxënësit (SchülerCard). Sidoqoftë, autoriteti i shkollës (Komuna e Bielefeld'it) ka përbushur detyrimin e saj për të mbuluar shpenzimet e udhëtimit në shkollë me ofertën karta e nxënësit (SchülerCard). Kështu, që çdo formë tjetër e lirit nga shpenzimet e udhëtimit përjashtohet.

* Nxënësit dhe nxënëset që ndjekin shkollat private mund ta shfrytëzojnë këtë ofertë nëse autoriteti i shkollës private ka lidhur një marrëveshje bashkëpunimi me MoBiel. Nëse ju duhet, ju lutemi pyesni në shkollën private.

** Nxënësve që u takon kjo e drejtë, e që banojnë jashtë Bielefeld'it do të vazhdojnë të marrin një biletë rruge për në shkollë.

Mjetet mësimore

Secilit nxënës i jepen / huazohen mjete mësimore për përdorim të kufizuar falas (pas zbritjes së kontributit vetjak) nga autoriteti shkollor (§96 Ligji i Shkollës). Prindërit paguajnë kontributin e tyre për vit shkollorë Sekundarstufe I maksimalisht prej 34 € (nga 102 €) në nivelin Sekundarstufe II, shumën prej 31 € (nga 93 €). (Në shkollën fillore të ulët ka një kontribut personal prej 16 € (nga 48 €) maksimalisht për materiale mësimore.) Ky kontribut nuk vlen për ata që marrin ndihmë sociale, por jo për ata që pranojnë Hartz IV. Në raste të jashtëzakonshme, materialet mësimore mund të vihen në dispozicion për përdorim të përhershëm nëse kërkohet nga natyra e materialeve mësimore.

Termi "material mësimor" nuk përfshin gjërat që përdoren në mësim si materiale praktike ose ushtrimi. Ato materiale mund të sigurohen nga prindërit si pjesë e pajisjeve të përgjithshme personale.

Këtu përfshihet letra që është e nevojshme për shkrim dhe vizatim, stilolapsat dhe kalkulatorët të të gjitha llojeve, duke përfshirë edhe ndihmat teknike dhe pajisjet e tjera të punës.

(Burim informate nga: Ministria e shkollës në Nordrhein-Westfalen;

<https://www.schulministerium.nrw.de/themen/recht/schulrecht/lernmittelfreiheit>)

Die Richtigkeit und Vollständigkeit vorstehender Übersetzung aus der deutschen Sprache wird bescheinigt.

Waldshut- Tiengen, den 29.09.2020,

Durch den Präsidenten des Oberlandesgerichts Hamm ermächtigter Übersetzer für die albanische Sprache.